



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 7 dhjetor 2011, në orën 9: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Time Kadriaj, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi dhe Liburn Aliu.

Munguan: Sasha Gjokiq, Fikrim Damka, Flora Brovina dhe Salihe Mustafa.

Të pranishëm: Xheladin Hoxha, shef i divizionit të komisioneve, Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi: Time Kadriaj, zv.kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Statusin dhe të Drejtat, Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre;
3. Të ndryshme.

3. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre

Time Kadriaj- Deklaroi se qëllimi i takimit të sotëm është shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për legjislacion përkitazi me Projektligjin për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Komisioni për legjislacion i ka propozuar tri rekomandime. Rekomandimi i parë kërkon që të fshihet nga preambula e ligjit fjalia “në bazë të rezolutës së Kuvendit të nxjerrë më 15 maj 2003, për luftën çlirimtare të popullit të Kosovës për liri e pavarësi”.

Bahri Thaçi- U pajtua që ky rekomandim të miratohet, sepse është e mjaftueshme që ligji ta ketë bazën e vet në Kushtetutë.

Liburn Aliu- Tha se pajtohem se baza është në Kushtetutë, por megjithatë unë abstenoj për këtë ligj, sepse kam problem me gjithë projektligjin për faktin se janë hequr vetëranët. Vërejtjet e mia nuk kanë më kuptim.

Pas diskutimeve, Komisioni më shumicë votash vendosi që të pranohet rekomandimi i parë i Komisionit për legjislacion.

Time Kadriaj- Deklaroi se rekomandimi i dytë ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit.

Liburn Aliu- Tha se ky parashihet në buxhet nga data 1 janar. Nëse vonohemi atëherë u shkaktojmë humbje këtyre kategorive, sa i përket fillimit të realizimit të pagesave sipas këtij ligji.

Bahri Thaçi- Deklaroi se varianti se si e kemi në projektligj është më i mirë.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi me shumicë votash që mos ta pranojë rekomandimin e dytë të Komisionit për legjislacion.

Time Kadriaj- Tha se rekomandimi i tretë ka të bëjë me përkufizimin e termit “Ministri e Mbrojtjes” të cilën Komisioni ynë e pati miratuar si amendament.

Liburn Aliu- Pyeti se ky term nënkupton Ministrinë e Mbrojtjes të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

Bahri Thaçi- Shpjegoi se ky term kur është propozuar ka nënkuptuar Ministrinë e Mbrojtjes të Qeverisë së Republikës së Kosovës në ekzil.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi me shumicë votash ta miratojë rekomandimin e tretë të Komisionit për legjislacion.

Mbledhja përfundoi në orën 9:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka